

# Rrugëtimi për miratimin e Planit Strategjik të Kuvendit



## Qershor 2019

Prezenca e OSBE në Shqipëri, mbështet Kuvendin që në bashkëpunim me ekspertë nga parlamenti austriak dhe grek, dhe me ekspertin kroat të NDI, të hedhin hapat e parë drejt hartimit të një dokumenti strategjik për Kuvendin. Gjatë qershorit organizohen takime vlerësuese dhe prezantuese për Planin Strategjik (Analiza SWOT-PEST).



## Korrik 2019

Ngrihet grupi i punës dhe zhvillohet mbledhja e parë. Miratohen Plani i Punës (*Roadmap*) dhe metodologjia e hartimit të Planit Strategjik të Kuvendit (2020-2025).



## Dhjetor 2019

Pas procesit të konsultimit të brendshëm, që përfshiu stafin civil dhe politik, deputetët, si dhe Aleancën e Grave Deputete në Kuvend, Grupi i Punës finalizon draftin e parë me prioritetet dhe objektivat strategjike, si dhe projektin Planin e Veprimit.



## Mars 2020

Kuvendi hap procesin e konsultimit të jashtëm, përmes publikimit të draft Planit Strategjik në platformën e konsultimit online [www.konsultimi.parlament.al](http://www.konsultimi.parlament.al).



## Maj 2020

Në përfundim të procesit të konsultimit të planit strategjik, u mblodhën rreth 126 komente, 75 prej të cilave u pranuan. Në këtë proces u përfshinë

- 153 përfaqësues të mediave;
- 17 përfaqësues të institucioneve të pavarura;
- 42 të rinj;
- 45 ish-deputetë;
- 200 përfaqësues të organizatave jofitimprurëse.



## Gusht 2020

Grupi i punës dorëzon draftin e finalizuar të Planit Strategjik te Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit. Dokumenti përfshihet në procedurat administrative dhe parlamentare.




## Dhjetor 2020

Me vendimin Nr.64, datë 29 dhjetor 2020, Byroja e Kuvendit miraton Planin Strategjik dhe Planin e Veprimit (2020-2025).

Projekti "Mbështetje për parlamentin dhe edukimin qytetar në Shqipëri" mbështetet nga qeveria Zviceriane dhe zbatohet nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Instituti Demokratik Amerikan

# Plani Strategjik i Kuvendit (2020-2025)

## Vizioni



Kuvend përfaqësues, efektiv, efiçient dhe transparent për qytetarët, drejt standardeve më të larta të demokracisë përfaqësuese.

## Misioni



Ligjbërje cilësore dhe kontroll parlamentar i fortë, pranë qytetarëve për konsolidimin e demokracisë, qeverisjen e mirë, zhvillimin, mirëqenien dhe integrimin evropian të Shqipërisë.

## Vlerat



- Përfaqësimi;
- Kushtetutshmëria dhe ligjshmëria;
- Llogaridhënia dhe gjithëpërfshirja;
- Barazia dhe mosdiskriminimi;
- Transparenca;
- Integriteti dhe etika;
- Profesionalizmi dhe kompetenca,
- Paanësia politike.

Projekti "Mbështetje për parlamentin dhe edukimin qytetar në Shqipëri" mbështetet nga qeveria Zviceriane dhe zbatohet nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Instituti Demokratik Amerikan



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
Prezenca në Shqipëri



## Prioriteti I

### Efektiviteti i ushtrimit të funksioneve përfaqësuese, legislative dhe mbikëqyrëse

- Përmirësimi i punës në procesin e shqyrtimit dhe miratimit të projektakteve në komisionet parlamentare dhe seancat plenare, duke përfshirë aspektet gjinore dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm;
- Përmirësimi i mekanizmave dhe praktikave të mbikëqyrjes parlamentare;
- Forcimi i bashkëpunimit Kuvend–qeveri, Kuvend–shoqëri civile dhe grupe interesi;
- Zbatimi efektiv i mekanizmit ndërinstitucional Kuvend–institucione të pavarura–ekzekutiv;
- Përmirësimi i ndërveprimit deputet–qytetar në ushtrimin e funksionit përfaqësues dhe llogaridhënies ndaj zgjedhësve;
- Përdorimi me efikasitet i teknologjisë së informacionit në përmirësimin e funksioneve të Kuvendit dhe punën në distancë.



## Prioriteti II

### Forcimi i kapaciteteve të Komisionit të Integritimit Evropian dhe të Këshillit Kombëtar të Integritimit Evropian

- Forcimi i kapaciteteve institucionale të Kuvendit për kontrollin e përputhshmërisë së projektligjeve me acquis të BE-së;
- Rritja e efektivitetit të monitorimit nga Kuvendi për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga MSA-ja dhe procesi i integritimit evropian të Shqipërisë;
- Rritja e efektivitetit të diplomacisë parlamentare në funksion të integritimit evropian dhe zgjerimit të marrëdhënieve dypalëshe e shumëpalëshe me parlamentet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare.



## Prioriteti III

### Transparenca, pjesëmarrja dhe edukimi qytetar në veprimtarinë e Kuvendit

- Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile, grupeve të interesit dhe publikut në procesin legjislativ, kontrollin parlamentar dhe aktivitete të tjera parlamentare;
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe angazhimit qytetar mbi veprimtarinë e parlamentit;
- Promovimi i pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse me anë të teknologjisë së informacionit;
- Përmirësimi i marrëdhënieve me median për pasqyrimin real të veprimtarisë së Kuvendit.



## Prioriteti IV

### Korniza rregullatore, burimet njerëzore dhe infrastruktura e Kuvendit

- Sigurimi i autonomisë financiare dhe administrative të Kuvendit;
- Rritja e kapaciteteve të administratës në përputhje me sfidat dhe kërkesat e reja;
- Përmirësimi i menaxhimit dhe komunikimit të brendshëm organizativ të administratës;
- Rritja e efektivitetit dhe paanshmërisë në ofrimin e shërbimeve kërkimore dhe edukuese nëpërmjet Institutit Parlamentar;
- Përmirësimi i hapësirave, mjediseve, pajisjeve dhe kushteve të punës me standarde të larta.

### Qëllimet strategjike

- Rritja e cilësisë së ushtrimit të funksioneve parlamentare;
- Forcimi i rolit të Kuvendit në procesin e integritimit evropian dhe i diplomacisë parlamentare;
- Rritja e transparencës, pjesëmarrjes dhe edukimit qytetar në veprimtarinë e Kuvendit;
- Përmirësimi i kuadrit rregullator, forcimi i burimeve njerëzore dhe përmirësimi i infrastrukturës.

### Monitorimi dhe vlerësimi

- Plani Strategjik i Kuvendit - proces në vazhdimësi, i cili do të monitorohet, vlerësohet dhe rishikohet;
- Plani i Veprimit - ndiqet dhe monitorohet çdo vit;
- Byroja e Kuvendit rishikon dhe përshtat Planin e Veprimit.

### Plani i Veprimit

- Aktivitetet konkrete për realizimin e secilit objektiv strategjik gjatë periudhës 2020–2025;
- Plani i Veprimit përmban 126 aktivitete, që do të zhvillohen nga vetë Kuvendi dhe/ose në bashkëpunim me partnerët mbështetës.



Projekti "Mbështetje për parlamentin dhe edukimin qytetar në Shqipëri" mbështetet nga qeveria Zviceriane dhe zbatohet nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Instituti Demokratik Amerikan